



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROJEKT VENDIM

NR ____ DATË. ____ . ____ .2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 127, DATË 26.11.2024
“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM/QIRA TË
SIPERFAQES TË FONDIT KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK”

Në bazë të: Në mbështetje të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5, pika 4, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Ligji nr.9693 datë, 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, të ndryshuar, Ligji nr.8480, datë: 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikës 52, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë, 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, pikës 5 shkronja “ç”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëmprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 27.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 559, Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

I propozojmë këshillit të bashkisë:

1. Te shqyrtoje kërkesën për dhënie të sipërfaqeve në përdorim :
5. *Sipërfaqes 70 ha, në pasurinë numer 1346, Zona Kadastrale nr.2498 në parcelën kullorë numer 8 me cilesimin kullorë, me kod KO03 00 008 Ekonomia Kullorë Çlirim, në vendin e quajtur Kisha e Kuqe Fshati Luaras prone Bashkiake.*

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve, Parqeve Dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.

2. Ky projekt- vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 neni 55, pika 6.

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

KRYETARI

Erion ISAI

NE MUNGESË DHE ME URDHER
NEN/KRYETAR

Petro RISTO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 3472 Prot

Ersekë më 11 . 7 . 2025

RELACION

PËR
DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 127, DATË 26.11.2024
“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM/QIRA TË
SIPERFAQES TË FONDIT KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK”

1. Baza ligjore

Në mbështetje të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënparagrafi 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5, pika 4, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Ligji nr.9693 datë, 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor”, të ndryshuar, Ligji nr.8480, datë: 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikës 52, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë, 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, pikës 5 shkronja “ç”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëmprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 27.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 559, Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

2. *Miratim paraprak i dhënies në përdorim të sipërfaqes 70 ha, në pasurine numer 1346, Zona Kadastrale nr.2498 në parcelën kullosore numer 8 me cilesimin kullote, me kod KO03 00 008 Ekonomia Kullosore Çlirim, në vendin e quajtur Kisha e Kuqe Fshati Luaras pronë Bashkiake.*

Pranë Drejtoria e Pyjeve, Parqeve Dhe Rekreacionit në Bashkinë Kolonjë Subjekti ka paraqitur kërkesë në formën e propozimit të pakërkuar për të marrë sipërfaqe në përdorim me kontratë qiraje. Kjo sipërfaqe ndodhet:

3. *Sipërfaqes 70 ha, në pasurine numer 1346, Zona Kadastrale nr.2498 në parcelën kullosore numer 8 me cilesimin kullote, me kod KO03 00 008 Ekonomia Kullosore Çlirim, në vendin e quajtur Kisha e Kuqe Fshati Luaras pronë Bashkiake.*

Në rastin e sipërpermendur zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë zhvillimin e energjisë së rinovueshme, punësim të komunitetit si dhe të ardhura të konsiderueshme në buxhetin e Bashkisë.

Theksojme se kjo eshte kerkese ne forme te pakerkuar, qe do te thote se pas miratimit paraprak qe do te behet ne Keshillin Bashkiak do ti neneshtrohen proceduare se konkurimit duke u shpallur per ankand ne Buletinin e Prokurimeve publike.

Bashkëlidhur me këtë relacion është paraqitur edhe hartat perkatese.

4. **Për diskutim:** *Miratim paraprak i dhënies në perdorim të sipërfaqes 70 ha, në pasurine numer 1346, Zona Kadastrale nr.2498 ne parcelen kullosore numer 8 me cilesimin kullote, me kod KO03 00 008 Ekonomia Kullosore Çlirim, ne vendin e quajtur Kisha e Kuqe Fshati Luaras prone Bashkiake.*

Mendojmë se zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë zhvillimin e energjise se rinovueshme, punesim te komunitetit si dhe të ardhura te konsiderueshme në buxhetin e Bashkisë.

Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të meren vendimet:

1. Te miratoje kërkesën për dhenie te siperfaqeve ne perdorim
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve , Parqeve dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 neni 55, pika 6.

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËN/KRYETAR

Petro RISTO

K R Y E T A R I

Erion ISAI

